



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/85

Datë: 20.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 79, 80 dhe 81 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/85

Datë: 20.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/85

Datë: 20.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për punën fitimprurëse të anëtarëve të familjeve të anëtarëve të një misioni diplomatik apo posti konsullor të karrierës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme që të zhvillojë negociata me Qeverinë e Republikës së Sllovenisë, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/85

Datë: 20.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për punën fitimprurëse të anëtarëve të familjeve të anëtarëve të një misioni diplomatik apo posti konsullor të karrierës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme që të zhvillojë negociata me Qeverinë e Republikës së Austrisë, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/85

Datë: 20.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shtetit të Panamasë për punën fitimprurëse të anëtarëve të familjeve të anëtarëve të një misioni diplomatik apo posti konsullor të karrierës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme që të zhvillojë negociata me Shtetin e Panamasë, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/85

Datë: 20.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, dhe pas vendimit të Bordit të Korporatës Amerikane Sfidat e Mijëvjeçarit (MCC) për ta përzgjedhur Kosovën vend kandidat që të zhvillojë programin Kompakt të ndihmës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Zyra për Sfidat e Mijëvjeçarit në Kosovë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
2. Zyra, fillimisht do të ketë Koordinatorin dhe Ekonomistin Kryesor.
3. Me qëllim të funksionimit të Zyrës për Sfidat e Mijëvjeçarit në Kosovë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ndahen mjete financiare në shumë prej 25,000.00 euro, ndërsa me rishikimin e Buxhetit kjo çështje do të rregullohet me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Mjetet nga pika 3. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë nën programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100 dhe barten në Zyrën e Kryeministrit në kategorinë mallra dhe shërbime në kodin 10600.
5. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Obligohet Zyra e Kryeministrit të përgatis aktin normativ për detyrat dhe përgjegjësitë që do t'i ketë Zyra për Sfidat e Mijëvjeçarit në Kosovë.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/85

Datë: 20.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38 të Ligjit 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për kryesues dhe anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
  - 1.1. Arsim Berisha, kryesues;
  - 1.2. Shkumbin Hyseni, anëtar;
  - 1.3. Ilmi Ahmeti, anëtar;
  - 1.4. Gezim Qerimi, anëtar.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin bashkë me biografite e të propozuarve, t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr.08/85

Datë: 20.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12 të Ligjit nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr.07/83 i datës 06.04.2016, për propozimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si në vijim: “pika 1.4. e Vendimit riformulohet dhe z. Mehmet Ballazhi zëvendësohet me z. Muhamed Krasniqi”.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin, bashkë me biografinë e të propozuarit, t’ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë